



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 619/2 Prot

Tiranë, më 28.06.2021

V E N D I M

Nr.85, datë 28.06.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të Kryeinspektorit nr. 1173 prot., datë 12.05.2021, “Tërheqje vëmendje”, për punonjësen ***, nëpunëse civile në Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

Vërej se:

Nëpërmjet kërkesës me nr. 619 prot., datë 17.05.2021, punonjësja ***** , nëpunëse civile në institucionin Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (shkurt ISHPSHSH), ka parashtruar pretendimet e saj, se drejtuesi i institucionit nëpërmjet shkresës nr. 1173 prot., datë 12.05.2021, i ka tërhequr vëmendjen, për komunikim jo të rregullt me kolegët dhe respektim të etikës në vazhdimësi, fakti cili është një ndëshkim disiplinor i padrejtë që e vë atë në pozita jo të favorshme në raport me vazhdimësinë e marrëdhënies në shërbimin civil.

Nëpunësja pretendon se, ky arsyetim ka kuptimin e shkeljes së parashikuar në nenin 57, pika 3, shkronja “c”, “*Shkelje e përsëritur e rregullave të etikës në shërbimin civil*” të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe sipas saj, titullari i institucionit, e ka vendosur atë, përballë një mase disiplinore, e cila jo vetëm që është e pabazuar, por çënon rëndë imazhin e saj si nëpunëse civile e vlerësuar maksimalisht për punën dhe integritetin e saj moral.

Emërtimi i shkresës, “*Tërheqje vëmendje*”, sipas nëpunëses, është bërë qëllimisht për të mbuluar mosrespektimin e rregullave që lidhen me kompetencën dhe procedurën e dhënies së masave disiplinore në shërbimin civil, si dhe të drejtën për tu dëgjuar, për të kërkuar sqarime, për tu mbrojtur, për tu ankuar, etj.

Për verifikimin e kërkesës së nëpunëses ***** , u kontaktua me njësinë e burimeve njerëzore të institucionit Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ku ju bë me dije se Komisioneri ka nisur verifikimin e pretendimeve të ngritura nga kjo nëpunëse dhe u kërkuan sqarime në lidhje me shkresës nr. 1173 prot., datë 12.05.2021, të Kryeinspektorit, si dhe, nëse në dosjen personale të kësaj nëpunëseje, është administruar ndonjë akt për dhënie mase disiplinore, që është akoma në fuqi.

Nga verifikimi i kryer nga Komisioneri, gjatë shqyrtimit të përmbajtjes së sqarimeve të dhëna si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, rezultoi se, nëpunësja civile ***** , kryen detyrën “*Inspektore*”, në Sektorin e Statistikës, në Drejtorinë e Inspektimit të Punës, në Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Nëpunëses në fjalë, në datën 12.05.2021, nëpërmjet e-mailit, i është komunikuar në rrugë elektronike nga ana e kryeinspektorit, një “*Tërheqje vëmendje*”, në përmbajtjen e të cilës është parashtruar se:

- në komunikimin e zhvilluar përmes postës elektronike (e-mailit zyrtar) me subjekt, “*Raport 3 mujor Janar – Mars*”, keni reflektuar një qëndrim jo produktiv dhe bashkëpunues, me Përgjegjësen e Sektorit dhe Drejtoren e Drejtorisë së Inspektimit të Punës.

Mospërfshirja në këtë analizë, e indikatorit të informalitetit dhe mosthellimi në konceptimin qartë të matjes së tij, çon në uljen e produktivitetit të punës së drejtorisë, pasi ai paraqet të dhënat vjetore të punës së inspektorëve të punës.

- në vazhdimësi komunikimi me kolegët, ka paraqitur problematika duke shkelur rregullat e etikës së nëpunësit civil, si dhe Rregulloren e Brendshme të ISHPSHSH-së.

- Për gjithësa më sipër, tërhiqet vëmendja me qëllim mbarëvajtjen sa më të mirë të punës, si dhe për të reflektuar dhe vlerësuar sjelljen dhe etikën në raport me marrëdhëniet me kolegët dhe eprorët.

Duke u nisur nga përmbajtja e shkresës së sipërcituar, drejtuar nëpunëses ***** , Komisioneri vlerëson se ndodhemi në rrethanat kur pas një analize periodike të punës, nisur nga disa të meta të konstatuara, ndër të tjera i është tërhequr vëmendja edhe inspektores në fjalë, duke nënvizuar rritjen e kujdesit dhe produktivitetit në punë në të ardhmen, si dhe përmirësimin e sjelljes dhe bashkëpunimit me drejtuesit dhe kolegët, siç e kërkojnë rregullat e etikës në shërbimin civil.

Kjo mënyrë e të vepruarit, tregon se nuk kemi të bëjmë me marrjen e një mase disiplinore, sipas përcaktimeve të kreut X, *“Disiplina në shërbimin civil”*, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*.

Në përmbajtjen e shkresës nr. 1173 prot., datë 12.05.2021, të Kryeinspektorit të ISHPSHSH, *“Tërheqje vëmendje”*, nuk konstatohen shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, por kemi të bëjmë me një tërheqje vëmendje, i cili vlerësohet se është një veprim me karakter të vazhdueshëm, të përditëshëm, me natyrë menaxheriale, e eprorit në kuadër të kryerjes së detyrës së tij për organizimin dhe kontrollin e punës.

Si i tillë, ky akt nuk shoqërohet me pasojat e një mase disiplinore, e për këtë arsye ai nuk duhet të vendoset e të ruhet në dosjen personale të nëpunëses, por nga ana tjetër ky fakt mund të mbahet parasysh nga eprori, në momentin e kryerjes së vlerësimit të mbarëvajtjes në punë të nëpunësit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe nenin 16, pika 6, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 619 prot., datë 17.05.2021, të nëpunëses *****; në lidhje ligjshmërinë e shkresës nr. 1173 prot., datë 12.05.2021, të Kryeinspektorit të ISHPSHSH, “*Tërheqje vëmendje*”, pasi nuk konstatohen shkelje të legjislacionit të shërbimit civil dhe arkivimin e çështjes.
2. Shkresa e Kryeinspektorit, nr. 1173 prot., datë 12.05.2021, “*Tërheqje vëmendje*”, të hiqet nga dosja personale e nëpunëses .
3. Të njoftohet për këtë vendim, institucioni Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, si dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha